

VENDIM
Nr. 390, datë 6.5.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT, FAKULTETI FILOLOGJIK - UNAZA
E MADHE TIRANË (OBJEKT+TRUALL)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, Fakulteti Filologjik - Unaza e Madhe Tiranë (objekt+truall)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “objekt” dhe “truall”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 52 979 606 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

a) objekt, me sipërfaqe 1 289 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) m² dhe vlerë shpronësimi 30 357 710 (tridhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë;

b) truall, me sipërfaqe 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m², me vlerë shpronësimi 22 621 896 (njëzet e dy milionë e gjashtëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “objekt” dhe “truall”, prej 52 979 606 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT”
 (FAKULTETI FILOLOGJIK - UNAZA E MADHE TIRANË (objekt+truall)

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi (m ²)	Sipërfaqe trualli (m ²)	Çmimi i truallit (lekë/m ²)	Vlera e truallit	Vlera e objektit	Vlera totale (lekë)	Shënime
1	Subjekti ndërtues “MAREG” Investitori Pavlin Kalusha	8160	5/84	Objekt polifunksional	1289				30357710	30,357,710	Leje ndërtimi
2	Fatos Babo +bp.	8160	5/84	Truall		396	57126	22621896		22,621,896	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	SHUMA TOTALE									52,979,606	